

# **UNIVERSITETI I PRISHTINES “HASAN PRISHTINA”**

## **ABSTRAKT**

**PROGRAMI I STUDIMEVE:** Fakulteti Juridik “Programi Juridiko-Financiar”

**KANDIDATJA:** Arbresha Reshani

**MENTOR:** Prof.Dr.Mejdi Bektashi

**TITULLI I TEMES:** “Funksionimi i kompanive te sigurimeve ne Republiken e Kosoves dhe menaxhimi i riskut”

Qëllimi i këtij studimi fokusohet në analizimin dhe shtjellimin e nocionit të kompanive te sigurimeve si dhe funksionimi i tyre në Republikën e Kosovës, analizimi i procedurave me rastin e paraqitjes së dëmeve si dhe kuptimin e riskut dhe format e menaxhimit të tij. Përmes këtij punimi është shqyrtuar në mënyrë analitike edhe legjislacioni në bazë të sëcilit zhvillojnë veprimtartinë e tyre kompanitë e sigurimeve si dhe roli i tyre kyq në ekonominë kombëtare. Punimi përmban gjithsej 60 faqe dhe është i ndarë ne pesë kapituj.

**Në kapitullin e parë** është paraqitur nocioni i sigurimeve, format e para të tyre si dhe parimet e domosdoshme të punës së kompanive të sigurimeve.

**Në kapitullin e dytë** është trajtuar historiku i kompanive të sigurimeve si dhe janë analizuar ligjet dhe disa nga rregulloret kryesore që përmbajnë rregulla për funksionimin e kompanive të sigurimeve. Ky kapitull më tutje vazhdon me analizimin e llojeve të sigurimeve me nëndarjen kryesore të tyre ne sigurimet jetë dhe sigurimet jo-jetë. Gjithashtu është trajtuar edhe roli i kompanive të sigurimeve ne ekonominë e Republikës së Kosovës.

**Në kapitullin e tretë** është bërë analizimi i kuptimit të kontratës së sigurimeve dhe veqorive të saj si dhe kushtet që duhet të përmbushin palët për nënshkrimin e kontratës. Më tutje janë shqyrtuar edhe subjektet e kompanive të sigurimeve ku rëndësi e veqantë u është dhënë ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe kushteve për licencimin e tyre. Është paraqitur edhe llogaritja

e primit në sigurime si dhe procedura që zhvillohet me rastin e paraqitjes së dëmeve. Pastaj në këtë kapitull është analizuar edhe kuptimi i risigurimit, llojet e tij si dhe bashkësigurimi.

**Në kapitullin e katërt** është paraqitur kuptimi i riskut të ndërlidhur me kompanitë e sigurimeve si dhe llojet e riskut. Më tutje është paraqitur edhe forma për përpilimin e pasqyrës së riskut si dhe janë shqyrtuar mundësitë për menaxhimin e riskut duke përdorur metodat më efikase. Është shqyrtuar edhe identifikimi i riskut, vlerësimi i tij si dhe zbatimi dhe rishikimi i metodës së zgjedhur.

**Në kapitullin e pestë** është prezentuar përfundimi i arritur përmes këtij punimi si dhe literatura e përdorur duke përfshirë tekstet nga autorë vendorë dhe ndërkombëtarë, ligjet dhe rregulloret.